



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

## **Komiteti për Partneritete Publiko Private**

### **DIREKTIVA NR. 5/2013**

#### **Për Mënyrën e Raportimit të Rregullt të Autoriteteve Publike tek KPPP**

Në pajtim me autoritetin që i është dhënë përmes Ligjit Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko Privat, Neni 17, Paragrafi 2.3, Komitetit për Partneritet Publiko Privat (KPPP) miraton këtë

## **Neni 1: Përkufizimet**

Termet e përdorura në këtë Direktivë, përveç nëse përcaktohen ndryshe, do ta kenë kuptimin e përcaktuar në Ligjin për Partneritet Publiko Privat (Nr. 04/L-045).

## **Neni 2: Raportimi i Rregullt**

Autoriteti Publik që ka hyrë në një marrëveshje kontraktuale apo institucionale për Partneritet Publik Privat duhet të raportojë në baza të rregullta vjetore, tek Komiteti për Partneritet Publiko Privat nëpërmjet Departamentit Qendror për PPP për çështjet që ndërlidhen me zbatimin e atij projekti.

KPPP ka të drejtë që pas raportimit të rregullt të kërkojë nga Autoriteti Kontraktues të raportojë edhe për çështje specifike të cilat nuk ndërlidhen me këtë raportimin, siç përcaktohet me nenin 17 paragrafi 2.9 i ligjit Nr. 04/L-045.

## **Neni 3: Afatet e Raportimit të Rregullt**

Raportimi i rregullt rreth implementimit të projektit PPP nga Autoriteti Kontraktues duhet të bëhet jo më vonë se në ditën e fundit të punës të muajit prill

## **Neni 4: Përmbajtja e Raportit**

Varësisht nga forma e Partneritetit Publik Privat raporti duhet të përmbajë nëse janë të aplikueshme informatat në vijim

- Informata të përgjithshme mbi projektin:
  - Palët kontraktuese
  - Qëllimi kryesor i projektit
  - Data e nënshkrimit të marrëveshjes
  - Data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes
  - Kohëzgjatja e projektit
  - Pronësia e aseteve
- Përmbushja e obligimeve nga Partneri Privat
  - Obligimet e investimeve
  - Obligimet operative
  - Obligimet e mirëmbajtjes
  - Pagesat e Tarifës së Koncesionit
  - Pagesat e Tarifave tjera

- Pasqyrë e përgjithshme financiare e partnerit privat për vitin financiar paraprak
- Ndërprerja dhe pezullimi eventual i Marrëveshjes për periudhën e raportimit
- Zbatimi i ndëshkimeve eventuale
- Mosmarrëveshjet eventuale
- Ndryshimi I marrëveshjes
- Përmbushja e obligimeve nga Autoriteti Publik
  - Pagesat e bëra nga autoriteti publik tek partneri privat (në rast të kontratës publike)
  - Ekipi për Menaxhimin e Kontratës
  - Sigurimi i posedimit të qetë
  - Obligime tjera

Aneksi 1 i kësaj Direktive përmban formatin e Raportimit të Rregullt.

### **Neni 5: Nënshkrimi i Raportit të Rregullt**

Ky raport para dorëzimit tek Departamenti Qendror për PPP duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi i Autorizuar i Autoritetit Publik si dhe përfaqësuesi i Partnerit Privat.

### **Neni 6: Hyrja në fuqi**

Kjo Direktivë do të hyjë në fuqi në ditën e miratimit të saj nga ana e KPPP dhe nënshkrimit të saj nga Kryesuesi i KPPP.

# ANEKS 1



## Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

**[Autoriteti Publik]**

Emri i projektit

**Raporti vjetor mbi**

**Projektin për XXX**

Nr. Prokurimit të PPP-së

**PPP-XXX-XX-XXX**

Periudha raportimit Muaji 20XX – Muaji 20XX

## 1. INFORMATAT E PËRGJITHSHME TË PROJEKTIT

Mëposhtë janë të përshkruara të gjitha informatat e përgjithshme të kërkuara sipas Direktivës #5 “Mënyra e Raportimit të Autoriteteve Publike tek KPPP” të aprovuar nga KPPP më [data] .

<i>Autoriteti publik</i>	<i>(Emri i Autoritetit Publik)</i>
<i>Partneri privat</i>	<i>(Emri i kompanisë së inkomporimit)</i>
<i>Qëllimi kryesor i projektit</i>	<i>(Qëllimi kryesor i projektit siç është definuar në marrëveshje)</i>
<i>Forma e PPP-së</i>	<i>(kontraktuale - koncesion, kontratë publike apo institucionale)</i>
<i>Data e nënshkrimit të marrëveshjes</i>	<i>(data pas negociimit dhe aprovimit nga Komiteti i PPP-së)</i>
<i>Data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes</i>	<i>(Data pas plotësimit të kushteve paraprake të marrëveshjes)</i>
<i>Kohëzgjatja e marrëveshjes</i>	<i>(afati i marrëveshjes prej datës së hyrjes në fuqi)</i>
<i>Pronësia e aseteve</i>	<i>(pronësia e aseteve gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes)</i>
<i>Informata shtesë</i>	<i>(informata tjera të rëndësishme për projektin)</i>

## 2. INFORMATAT MBI PËRMBUSHJEN E OBLIGIMEVE NGA PARTNERI PRIVAT<sup>1</sup>

### 2.1. Përbushja e obligimeve nga Partneri Privat

Partneri Privat është i obliguar të përbush kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në marrëveshjen së PPP-së, si mëposhtë:

Obligimet e investimeve (Nëse janë të aplikueshme)	<i>(Përshkrim i kushteve të investimeve, a janë duke u përbushur obligimet e investimeve në bazë të kërkesave dhe sipas në afateve të parapara)</i>
Obligimet operative (Nëse janë të aplikueshme)	<i>(Përshkrim i obligimeve operative, a janë duke u përbushur në bazë të kërkesave)</i>
Obligimet e mirëmbajtjes (Nëse janë të aplikueshme)	<i>(Përshkrim i obligimeve të mirëmbajtjes, a janë duke u përbushur në bazë të kërkesave)</i>
Pagesat e Tarifës se Koncesionit (Nëse janë të aplikueshme)	<i>(Përshkrim i mënyrës të mirëmbajtjes, a janë duke u përbushur në bazë të kërkesave)</i>
Pagesat e Tarifave të Transaksionit dhe Mbikëqyrjes	<i>(Përshkrim i obligimeve tjera relevante që duhet të përbushen nga Partneri Privat)</i>
Obligimet tjera relevante (Nëse janë të aplikueshme)	<i>(Përshkrim i obligimeve tjera relevante që duhet të përbushen nga Partneri Privat)</i>

<sup>1</sup>Direktiva #5 “Mënyra e Raportimit të Autoriteteve Publike tek KPPP” të aprovuar nga KPPP. Neni 3 Përmbajtja e Raportit, Direktiva #5

**2.1.1.Pasqyrë e përgjithshme financiare e partnerit privat për vitin paraprak financiar**

*(Pasqyrat e audituara financiare të Partnerit Privat, bashkëngjit raportin e Auditorit)*

**2.1.2.Ndërprerja dhe pezullimi eventual i Marrëveshjes për periudhën e raportimit**

*(Nëse janë të aplikueshme - Përshkrim i ndërprerjes dhe pezullimit eventual të Marrëveshjes për periudhën e raportimit, arsyet dhe kushtet)*

**2.1.3.Zbatimi i ndëshkimeve eventuale**

*(Nëse janë të aplikueshme - Përshkrim i zbatimit të ndëshkimeve siç janë paraparë me Marrëveshje)*

**2.1.4.Mosmarrëveshjet eventuale**

*(Nëse janë të aplikueshme - Përshkrim i ndonjë mosmarrëveshje në mes të palëve kontraktuese, si dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre)*

## **Përbushja e obligimeve nga Autoriteti Publik**

Autoriteti Publik është i obliguar të përmbush kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në marrëveshjen së PPP-së, si më poshtë:

### **2.1.5. Pagesat e bëra nga autoriteti publik tek partneri privat**

*(Në rast të kontratës publike – Përshkruani pagesat e bëra nga Autoriteti Publik, (Bashkëngjit kopje të certifikatave të pagesave)*

### **2.1.6. Ekipi për Menaxhimin e Kontratës**

*(Autoriteti Publik ka themeluar dhe vazhdon të ketë Ekipin për Menaxhim të Kontratës, për sigurimin e zbatimit të plotë të kushteve të Kontratës. dhe vazhdon të menaxhimin dhe monitorimin gjatë kohëzgjatjes së Marrëveshjes. Përshkruani pozitat e EMK-së)*

### **2.1.7. E drejta e posedimit të qetë të vendndodhje**

*(Nëse është e aplikueshme - Përshkrim i vazhdimit të sigurimit të së drejtës për posedim të qetë)*

### **2.1.8. Obligime tjera**

*(Nëse janë të aplikueshme - Përshkrim i obligimeve tjera eventuale të përcaktuara me Marrëveshje)*



Ky raport përmban informata të sakta dhe paraqet një pasqyrë mbi mbarëvajtjen e projektit të lartcekur për periudhën e raportimit.<sup>2</sup>

---

Përfaqësuesi Autorizuar i Autoritetit Publik

---

Përfaqësuesi Autorizuar i Partnerit Privat

---

<sup>2</sup>Direktiva nr. 5/2013 “Mënyra e Raportimit të Rregullt të Autoriteteve Publike tek KPPP” të aprovuar nga KPPP.

**Neni 4, Nënshkrimi i Raportit**

Ky raport para dorëzimit tek Departamenti Qendror për PPP duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi i Autorizuar i Autoritetit Publik si dhe përfaqësuesi i Partnerit Privat.



**INFORMATAT KONTAKTUESE**

Ju lutemi drejtoni kërkesat dhe pyetjet te:

Partneritetet Kosova  
Ministria e Financave  
+381 (0)38 200 34 013/202

[www.pppkosova.org](http://www.pppkosova.org)